



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-01

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 mars 2017

Titulli: Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave
bazuar në nenin 19 (5) të Ligjit

PUBLIK

VENDIM

**për caktimin e gjykatësve në një Panel të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të
Specializuara**

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi, cakton Panelin e Gjykatës Kushtetuese (“Paneli”), për rishikimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”).

1. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenare”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan Rregulloren.

2. Më 27 mars 2017, Kryetarja, duke vepruar në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.¹

3. Në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, pas referimit në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari cakton tre gjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në përbërje të një Paneli të Gjykatës Kushtetuese. Në rast pamundësie të kryerjes së detyrës prej njërit nga këta gjykatës, Kryetari cakton një gjykatës kushtetues rezervë.

4. Në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, Paneli ka tridhjetë (30) ditë për rishikimin e Rregullores dhe për marrjen e vendimit. Ligji nuk parasheh kurrfarë zgjatjeje të këtij afati. Duke pasur parasysh këtë afat të përcaktuar rreptësisht, pjesëmarrja e gjykatësit kushtetues rezervë në kuvendimet gjykohet e domosdoshme për të garantuar vijimësinë e punës së Panelit, në rast pamundësie të kryerjes së detyrës prej njërit nga gjykatësit e caktuar, gjatë afatit tridhjetëditësh.

¹ Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarja, Nr. KSC-CC-PR-2017-01, 27 mars 2017.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, NË VIJIM, KRYETARJA

Cakton gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në përbërje të Panelit të Gjykatës Kushtetuese për rishikimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave, për të garantuar përputhshmërinë e Rregullores me Kapitullin II, duke përfshirë edhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si më poshtë:

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatëse An Pauër-Ford

Gjykatës Vidar Stensland, dhe

Gjykatës Antonio Balsamo, si gjykatës rezervë

/Nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 27 mars 2017

Në Hagë, Holandë.